



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS



DETYRË PROJEKTIMI

(Terma Refence të
Përgjithshme)

**PËR PROJEKTIMIN E OBJEKTIT: STUDIM PROJEKTIM I PROJEKTEVE PRIORITARE TE
INFRASTRUKTURES PUBLIKE NE BASHKINË E DURRESIT.**

MIRATOHET

ZEVENDESKRYETAR

Elio Jani



PËRMBLEDHJE

DETYRE PROJEKTIMI	3
1 HYRJE.....	3
2 VENDNDODHJA E OBJEKTIT TË STUDIMIT	3
3 OBJEKTI I NDERHYRJES, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA.....	4
3.1. Objektivi i ndërhyrjes.....	4
3.2. Qëllimi i projektit.....	4
4 KËRKESAT E PROJEKTIT	4
5 REALIZIMI I PROJEKTIT	6
6 ORGANIZIMI, PLANI I PUNËS DHE STAFI I KËRKUAR.....	7
6.1. Gjuha e përdorur, komunikimet, raportimet dhe takimet.....	7
6.2. Rekomandime për projektuesin.....	8
6.3. Raportet për dorëzim.....	8
6.3.1 Analiza e detyrës së projektimit (brenda 1 jave nga fillimi).....	8
6.3.2 Raporti i rilevimit topografik, studimin gjeologjik, etj...(brenda 2 jave nga fillimi) 9	
6.3.3 Projekti zbatimi (brenda 8 jave nga fillimi).....	9
6.3.4 Pergatitja e dosjes per oponente teknike (brenda 1 jave).....	10



DETYRE PROJEKTIMI

OBJEKTI

“Studim Projektim i projekteve prioritare te infrastruktures publike ne Bashkinë e Durrësit”

1 HYRJE

Bashkia Durrës në kuadër të zhvillit të qytetit dhe përmirësimit të infrastrukturës publike ka përcaktuar në buxhetin e bashkisë për vitin 2024 hartimin e projekteve prioritare per kete vit buxhetor. Nisur dhe nga shqetesimet dhe kerkesat e banoreve Drejtoria e projekteve dhe infrastruktures Publike ka parashikuar qe me kete buxhet te realizoj studim projektimin e 5 pallateve te demtuara nga termeti i vitit 2019 te cilet nga akt ekspertiza e thelluar e hartuar nga Instituti i Nertimit jane klasifikuar me nivel demi DS4.

Objekti i ndërhyrjes: Hartim projektit të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse, për objekte të dëmtuara nga tërmeti datës 26.11.2019 me nivel dëmi DS4, në analizat e thelluara të të cilave Instituti i Ndërtimit rekomandon përforcimin e tyre sipas eurocod 8.

1. Lista e dokumentacionit të vënë në përdorim të konsulentit në dispozicion nga Bashkia e Durrësit.
2. Lista e dokumentacionit që duhet paraqitur nga konsulenti.
3. Kualifikimet e stafit të subjektit konsulent.

2 VENDNDODHJA E OBJEKTIT TË STUDIMIT

NR	OBJEKTE	Nr. KATI	ADRESA	kordinata	G.I.S	SIPERFAQE
1	Pallati nr 16	5 Kat	Rruga Jahja Ballhysa , lagjia nr 17	N41.320077, E 19.455311	3102	1300
2	Pallati nr 27	5 Kat	Rruga Dalip Peza , lagjia nr 17	N41.318490, E 19.459905	1484/1	700
3	Pallati Mustafa Pash Bushati	5 Kat	Rruga Bajram Tusha , lagjia nr 14	N41.3294120, E 19.491185	4911	1600
4	Pallati nr 18 (901	5 Kat	Rruga Kristo Sotiri , lagjia nr 18	N41.327276, E 19.447882	22378	1650
5	Pallati nr 103	5 Kat	Rruga Aleksander Goga , lagjia nr 9	N41.327276, E 19.447883	24935	1350
6	Pallati nr 196	8 Kat	Rruga Pavaresia	N4130795,E1948866	5513	1800
7	Pallati nr 52	5 Kat	Rruga Hysen Kertusha	N411927.98,E192715.48	23005	1400
SHUMA E SIPERFAQEVE						9800



3 OBJEKTI I NDERHYRJES, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

3.1. Objektivi i ndërhyrjes

Në kuadër të Investimeve të miratuara ne Buxhetin e vitit 2024 Bashkia Durrës kërkon realizimin e projektit për **“Studim Projektim i projekteve prioritare te infrastruktures publike ne Bashkinë e Durrësit”**.

Objekti i këtij projekti Hartim projektit të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse, për objekte të dëmtuara nga tërmeti datës 26.11.2019 me nivel dëmi DS4, në analizat e thelluara të të cilave Instituti i Ndërtimit rekomandon përforsimin e tyre sipas eurocod 8.

Lista e dokumentacionit të vënë në përdorim të konsulentit në dispozicion nga Bashkia e Durrësit.

- Plnavedosja me pozicionin e objekteve
- Analizat e thelluara të ardhura nga Instituti i ndërimit;
- Lista e objekteve me kodin Gis.

3.2. Qëllimi i projektit

Pergatitja e projekti te riforcimit me qellim zbatimin e tij ne terren dhe Qellimi kryesor i kesaj detyre projektimi eshte realizimi i projektit te zbatimit per rikonstruksion e 7 pallateve te demtuara nga termeti , i cili do te mundesoje financimin dhe zbatimin e tyre me fonde te Buxhetit te Shtetit apo te Bashkise Durrës ne vazhdim.

4 KËRKESAT E PROJEKTIT

LISTA E DOKUMENTAVE TË ANALIZËS SË THELLUAR DHE PROJEKTEVE TË NDERHYRJEVE QË DUHEN PARAQITUR SIPAS VKM 26, date 15.01.2020

- Studimi i dokumentacionit te percaktuar ne shkronjen (a) të pikes 4 te VKM 26, date 15.01.2020.
- Studimin e strukturave sipas përcaktimeve të SSH EN 1998-3:2005:
 - Studimi gjeometrik
 - Studimi i materialit.
 - Studimi i detajimeve.
- Studimin e strukturave, që do të shoqërohet me kryerjen e testeve, me shkatërrim dhe pa shkatërrim, sipas përcaktimeve të dhëna në standardin shqiptar SSH EN 1998-3:2005, ose specifikimeve teknike dhe/ose standarde të tjera të barasvlefshme me të;
 - Realizimin e studimit gjeologjik.
 - Realizimin e studimit sizmik.
 - Në mungesë të projekteve, do të realizojë projektim simulues bazuar në kushtet teknike në fuqi.
 - Evidentimin dhe katalogimin e dëmtimeve.



- Analizën lineare, sipas përcaktimeve të dhëna në standardin shqiptar SSH EN 1998-3:2005, ose specifikimeve teknike dhe/ose standardeve të tjera të barasvlefshme me të, të përshtatshme për tipin e strukturës. Ngarkimi sizmik të bëhet sipas procedurës së përcaktuar në standardin shqiptar SSH EN 1998-3:2005 ose specifikimeve teknike dhe/ose standarde të tjera të barasvlefshme me të.
- Analizën jolineare, sipas përcaktimeve të dhëna në standardin shqiptar SSH EN 1998-3:2005, ose specifikimeve teknike dhe/ose standardeve të tjera të barasvlefshme me të, sipas njëres nga metodat e përshtatshme për tipin e strukturës që po analizohet.
- Konkluzionin për performancën e godinës sipas metodologjisë bazuar në standardin shqiptar për sizmicitetin dhe ngarkimin sizmik, sipas kushteve teknike dhe procedurave, sipas përcaktimeve në specifikimet teknike dhe/ose standardeve të tjera të barasvlefshme me standardin shqiptar për sizmicitetin.
- Rekomandimet për ndërhyrjet strukturale të nevojshme për kthim të strukturës konform kushteve teknike dhe përshtatjen sipas standardeve shqiptare ose specifikimeve teknike dhe/ose standardeve të tjera të barasvlefshme me to.
- Projekti i ndërhyrjeve rehabilituese përshtatëse hartohet në bazë të kushteve teknike të projektimit në fuqi dhe të standardeve evropiane të transpozuar. Hartimi i projektit mbështetet në rekomandimet e analizës së thelluar dhe përfshin të gjitha detajet e nevojshme për ndërhyrje si dhe metodologjinë e aplikimit.
- Relacioni i përgjithshëm i projektit. Format A4
- Metodologjia e ndërhyrjeve. Format A4
- Projekti ndërhyrjeve: Format A3, A2, A1.
 - Planimetri
 - Pamje
 - Prerje
 - Detaje Arkitektonike, konstruktive.
 - Detaje Zbatimi
 - Relacionet dhe specifikimet përkatëse

Shenim Teknik : Te gjitha Vizatimet Arkitektonike te jene ne shkallen 1 : 100; 1:200; 1:500

Prerjet ne shkallen 1:25; 1:50; Detajet arkitektonike, konstruktive, sh 1:5,1:10

- Projekt ndërhyrjeve dhe riparimit të rrjetit të infrastrukturës inxhinierike: *Format A2, A1, A0*
 - Planimetri të infrastruktures, elektrik, kanalizime, kub. *Format A2, A1, A0*
 - Detaje zbatimi
 - Prerje
 - Relacionet dhe specifikimet përkatëse.
- Preventivi i punimeve duhet të jetë në ndraë në preventivin e punimeve të riforcimit të godinës dhe preventivin e rikonstruksionit të apartamenteve të banimit.
Preventivi duhet të shoqerohet me analiza e tyre, sipas manualeve ne fuqi te miratuar nga Ministria, i shoqeruar me specifikimet teknike perkatëse.

Format A4

- Grafiku i punimeve

- Oponenca teknike e projektit.

Projekti i përforcimit të objekteve në zbatim të VKM 26.datë 15.01.2020 duhet ti miratohet nga Instituti i Ndërtimit/Universiteti Politeknik i Tiranës dhe pagesa e oponences do te kryhet nga Bashkia Durres.

- Projekti do te hartohet dhe paraqitet ne 3 kopje, te printuara sipas formateve te specifikuara me siper dhe informacioni tërësisht i dixhitalizuar (dwg, pdf, Word, exel, Sap ose Etaps) ne 3 kopje CD.
- Kopja elektronike e projektit eshte pjese perberese e dokumentacionit teknik te dorezuar dhe duhet te jete ne formatet ne formatit PDF me firme digitale.
- Dorezimi do te behet prane Drejtorise se Projekteve dhe Infrastruktures Publike ne Bashkise Durres.

Laboratori i testimeve te materialeve te ndertimi duhet te sjelle analisat sipas ketyre standarteve:

1. Beton i ngurtësuar sipas standartit : ASTM C39/ C39M-20; ASTM C642- 13
2. Element për muraturë sipas standartit: SSH EN 772 - 11: 201.
4. Llac sipas standartit: SSH EN 1015-10:2005; SSH EN 1015-18:2005
5. Agrtegate sipas standartit SSH EN 933- 4:2008
6. Çimento sipas standartit SSH EN 196- 1: 2016
7. Dhera sipas standartit ASTM D7263 - 09(2018)e2
ASTM D1556/D155 6M-15E1 AASHTO T 191- 14(2018)

5 REALIZIMI I PROJEKTIT

Realizimi i projektit të rirforcimit do të mbështetet në **VKM 26. Datë 15.01.2020** ku jepen tarifat si më poshtë;

- Dokumentimi gjeometrik dhe teknik
- Analiza strukturore e thelluar e cila përfshin azhornimin gjeometrik dhe teknik:
 - a. Provat laboratorike
 - b. Studimin e thelluar
- Projekti i ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse, relacion dhe preventive.

Siperfaqja e ndërtimit e 7 pallateve sipas analizave të insitutit te ndertimit dhe të nxjerra nga DATECH është afersisht 9800 m².

Duke qënëse një pjesë e objekteve sipas akt konstatimeve dhe analizave të Institutit nuk do të përfundojnë për të realizuar Projektet e ndërhyrjeve rehabilituese, nuk mund te kemi nje parashikim te sakte per vleren limit te kontrates. Nderkohe me siperfaqet perafersisht te mesiperme dhe duke zbatuar tarifat e VKM perlllogaritja e fondit del me shume.

Per procesin e rirforcimit kemi dy raste:

1. Dokumetacionin sipas VKM nr.26. dt.15.01.2020 per dorezimit te plote te Projektit per ndërhyrjeve rehabilituese si me poshte:

- Dokumentimi gjeometrik dhe teknik

- Analiza strukturore e thelluar e cila përfshin azhornimin gjeometrik dhe teknik:
 - a. Provat laboratorike është
 - b. Studimin e thelluar është Projekti i ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse, relacion dhe preventive

2. Dokumentacionin sipas VKM nr.26. dt.15.01.2020 per dorezimit e dokumentacionit si me poshte:

- Dokumentimi gjeometrik dhe teknik
- Analiza strukturore e thelluar e cila përfshin azhornimin gjeometrik dhe teknik:
 - a. Provat laboratorike
 - b. Studimin e thelluar

Pasi per nje pjese te objekteve mund te jete e pamundur hartimi i projektit te rforcimit sepse:
-Provat laboratorike të matërialeve mund të dalin qe nuk i plotësojnë markat dhe standartet e kërkuara.
-Një pjesë e objekteve kanë pësuar inklinime të mëdhaja.
-Një pjesë e objekte mund të rezultojnë që ndërhyrjet për riparimin e strukturës kushtojnë më shumë se 70% e kostos së rindërtimit nga e para.

Sa me siper procesi i rforcimit ndahet ne dy raste:

1. Kandidati/ofertusi do të paguhet për te gjithë dokumentacionin sipas VKM nr.26. dt.15.01.2020 me dorezimit te plote te Projektit per ndërhyrjeve rehabilituese si me poshte:

- Dokumentimi gjeometrik dhe teknik është (oferta) l/m²
- Analiza strukturore e thelluar e cila përfshin azhornimin gjeometrik dhe teknik:
 - a. Provat laboratorike është (oferta) l/m²
 - b. Studimin e thelluar është (oferta) l/m²
 - c. Projekti i ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse, relacion dhe preventive është (oferta) l/m²

Sipas cmimeve/ofertes qe do te konkurojë

2. Kandidati/ofertusi do të paguhet për ate dokumentacionin sipas VKM nr.26. dt.15.01.2020 pasi te jete marre oponenca teknike e miratuara nga Instituti i Ndërtimit, me dorezimit e dokumentacionit si me poshte:

- Dokumentimi gjeometrik dhe teknik është (oferta) l/m²
- Analiza strukturore e thelluar e cila përfshin azhornimin gjeometrik dhe teknik:
 - a. Provat laboratorike është (oferta) l/m²
 - b. Studimin e thelluar është (oferta) l/m²

Sipas cmimeve/ofertes qe do te konkurojë



6 ORGANIZIMI, PLANI I PUNËS DHE STAFI I KËRKUAR

6.1. Gjuha e përdorur, komunikimet, raportimet dhe takimet

Gjuha zyrtare e komunikimit dhe raportimit është shqip. Përveçse nëse shprehet ndryshe, raportimi do të jetë në gjuhën angleze, si dhe në takimet / workshopet e mbajtura dhe

proçesverbalet e takimeve. Një takim fillestar me përfituesit dhe palët e tjera të interesuara, do të mbahet brenda 2 javëve të para nga fillimi i Projektit. Këshillohet që, takimet e rregullta të progresit të mbahen çdo 2 muaj, apo edhe të rastit, nëse është e nevojshme për të zgjidhur çështje specifike. Konsulenti do të mbikqyret nga Grupi Teknik i Punës i krijuar nga Bashkia Shijak.

Grupi Teknik i Punës (GTP) do të koordinojë të gjitha aktivitetet, duke përfshirë komunikimin ndërmjet Konsulentit dhe Përfituesit si dhe autoriteteve të tjera kompetente. Takime të rregullta mujore do të mbahen me GTP, përfaqësuesit e Përfituesve dhe palët e tjera të interesuara për të raportuar dhe diskutuar mbi progresin e arritur, çështjet kritike dhe të gjitha aspektet e tjera të zbatimit të kësaj detyre. Proçesverbali i takimeve do të përgatitet nga Konsulenti dhe do t'u shpërndahet të gjithë pjesmarrësve. Përveç kësaj, mund të kërkohen takime të rastit (ad-hoc), me kërkesë, dhe me pjesmarrjen e Përfituesve dhe përfaqësuesve të GTP-së. Udhëheqësi i Ekipit (menaxheri i skuadrës) i Konsulentit do të udhëheqë detyrën, dhe ai/ajo do të jetë përgjegjës për mbikqyrjen e ekipit të ekspertëve, për sigurimin e progresit të detyrës në përputhje me planin, për koordinimin me palët e interesuara dhe për raportim. Ekipi i ekspertëve do të zhvillojë takime me palët e interesuara siç përcaktohet në planin e punës dhe do t'i mbajë të informuar për progresin e arritur dhe çdo çështje tjetër që ndodh në zbatimin e detyrës.

Ekipi i ekspertëve do të punojë dhe do të koordinojë Termat e Referencës:

6.2. Rekomandime për projektuesin

- a) Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues.
 1. Lista e objekteve/ndertesa pallat
 2. Lista e objekteve/banesa
 3. Analizat e Insitutit të ndertimit
 4. Harta e vendodhjes se objekteve
- b) Për hartimin e preventivit projektuesi duhet të mbështetet në VKM ne fuqi dhe te paraqitet sipas formati te kerkuar. Për secilin zë punimi, i cili nuk është i përfshirë në këtë manual, projektuesi duhet të dorëzojë analizat e çmimeve.

6.3. Raportet për dorëzim

Konsulenti do të ofrojë sa vijon:

6.3.1 Analiza e detyrës së projektimit (brenda 1 jave nga fillimi).

Konsulenti do të kryej vizita në terren për mobilizim dhe do të mbajë takime me palët e interesuara. Konsulenti do të përgatisë Raportin Fillestar duke përfshirë planin e veprimit, metodologjinë etj, të cilat, pas rishikimit, do të bëhen një udhëzues për pjesën e mbetur të projektit duke ofruar udhëzimet e nevojshme. Kohëzgjatja e parashikuar e këtij aktiviteti është 1 jave.



Si pjesë e këtij aktiviteti, Konsulenti do të kryejë detyrat e mëposhtme:

- Takimi prezantues, koordinimi dhe marrëveshja për detyrën me palët kryesore të interesuara.
- Organizimi i fillimit të detyrës (logjistika, përmbajtja, plani i punës, etj.) në mënyrë që aktivitetet pasuese të mund të zhvillohen pa probleme. Mobilizimi i ekipit të ekspertëve.
- Vizita në terren dhe vrojtimi vizual.
- Marrja nga autoritetet dhe rishikimi i studimeve të mëparshme, dokumentacionin e projektimit dhe informacionin bazë për t'u njohur me dokumentacionin në dispozicion.

Kryerja e një vlerësimi të objektivave të Termat e References (ToR) kundrejt dokumentacionit të disponueshëm dhe situatës aktuale në fillim të periudhës së zbatimit dhe sugjerimi mbi ndryshimet e nevojshme, sipas nevojës për qasjen, metodologjinë dhe programin.

6.3.2 Raporti i rlevimit topografik, studimin gjeologjik, etj...(brenda 2 jave nga fillimi)

Konsulenti do të përgatisë raportin e rlevimit topografik. Raporti duhet të përfshijë të gjitha të dhënat e marra nga terreni, fletët topografike etj, dhe komentet/konkluzionet e ekspertëve. Studimi gjeologjik, sizmologjik, etj., duhet të përfshijë të gjitha të dhënat e marra nga terreni për të gjitha objektet dhe do të hartohet raportet për çdo objekt duke përfshirë dhe konkluzionet e specialisteve të fushës.

6.3.3 Projekti zbatimi (brenda 8 jave nga fillimi)

Dosja e plotë e projektit të zbatimit do të përmbajë:

- a) Raportet teknike (konstruktiv, topografik, gjeologjik, hidroteknik, sizmologjik, gjeologjik, gjeoteknik, arkeologjik dhe mjedisor)
- b) Planvendosjen e objektit
- c) Planimetritë
- d) Rilevimin topografik
- e) Projekti teknik (konstruktiv, topografik, gjeologjik, hidroteknik, elektrik, sizmologjik, gjeologjik, gjeoteknik, hidrologjik dhe mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, etj...)
- f) Specifikimet teknike për zërat e punimeve që do të kryhen;
- g) Preventivin e punimeve mbështetur në manualet teknike të çmimeve në fuqi;
- h) Grafikon e punimeve të detajuar sipas zërave të punës;
- i) Plan organizimin e punimeve dhe ngritjen e kantierit në funksion të mjeteve, që do të jenë pjesë e realizimit të objektit, mbështetur dhe në grafikon e punimeve;
- j) Raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM);

k) Liçencë të firmës projektuese, liçencë të ekspertit mjedisor dhe ekstrakt i regjistrit tregtar.

l) Deklaratat e përgjegjësisë profesionale të stafit pjesmarrës në realizimin e studim-projektimit.

6.3.4 Përgatitja e dosjes për opoenca teknike (brenda 1 jave)

Dosja e plotë e projektit të zbatimit do të dërgohet nga Bashkia Durrës për opoenca teknike pranë Institutit të Ndertimit ose Universitetit Politeknik të Tiranës dhe konsumlenti. Konsulenti do të plotësojë të gjithë rekomandimet apo vërejtjet që do lindin nga opoenca teknike brenda afatit. Pagesa e opoenes teknike do të paguhet nga bashkia Durrës. Kontrata quhet e realizuar kur merret opoenca teknike e objektit.

Grupi i hartimit të detyrës së projektimit

Ing. Hidroteknik Lorenc Facja

Ing. Ndertimi Ilva Hasanaj

Ing. Ndertimi Jetmir Kurti

Ing. Ndertimi Eni Turkeshi

Ing. Elektrik Mariglen Jahollari

Ing. Gjeodet Enli Kaçuli

